

Hylli i Dritës

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.

(II. ad Cor. III. 17.)

1. Çka na dán — çka na bashkon	Fq. 577
2. Per Kulturen e Popullit	" 586
3. I mbrami vezir i Shkodres	" 591
4. Nji Dorshkrim i vjetës 1671 mbë	
Shqypni	" 605
5. Ifigenija n' Aulli	" 614
6. Nji ekskursjon botanik deri në Shirokë,	" 622
7. Nder lamije të ditunis	" 632

POSTA E JONË

■ TË GJITH ABONATVE u lajmojm se jemi gadi me u a dergue rishlas ndo 'i numer, që nuk u kâ mrrri rokull ktyne muejve, me porosi veç që të merren vesht mirë me zyre postare të vendit, perpara se me na lippë në numrin, që nuk u kâ râ në dorë.

TIRANË: N. M. Me të distue të drejtën, deri sot nuk na kâ mrrjëtë në Redaksjon as liber as Rivistë e déjë per kritikë. Sá per Rivisten „Neo-shqyptarizma“ mundemi me u thënë se nuk do t' a kishim lânë pâ e permendë, por pritem edhe ndo 'i numer tjeter perpara se nje dhâne mi të gjyqjin t' onë.

TIRANE: GJ. B. Në falni. U a kemi vonue pernjamend.

GJINOKASTER: F. „D-a“ Bindemi. E prâ u a kemi nisë per gjith muej. Fajt do të jetë në zyre postare.

VLONË: K. L. Keni arrsyetë plotë me u ankue per sâ u shkruekan prej Jugosllavijët, por s' keni shka bâjm; Rivista e jonë është e ndaluar me prej Qeverijet jugosllave; kaq mundna veç me u sugurue se per të gjith abonatt në Jugosllavi kemi mendue me i rucjtë më një tê tanë numrat e rjetit: i kan gadi kuerdoherë.

IBALLE: A. S. E prâ u a kemi nisë rrregullisht.

PAŁC: A. C. Fajt do t' a keni vëtë. Vendis, kâ na keni shenjue adresën, udoshtu u a kâ vonue numrat.

FLORENCE: SH. „Z-i“ Spresojm se i keni marrë e-dhe numrat e perparshem; sâ pec rjetë tê vë do të mendohena; pteqnonje e është ju vëtë.

Çka na dán — çka na bashkon.

Empedokles prej Akragas në Sicilje, i dieshmi i botës, si u kandej Helenve t' a thrrasin, 24 kavaljete para Krishtit pat folë e thâné se gjith procesi i botës pshtetej në nji bashkim e zë nji të dám elementash e se dy jânë fuqít të eillat, me nji shndrrim të perhershëm; veprojn në ket bashkim e në kta të dám; dashtnija e mnija. S'e kemi ktû menden me folë gjâ permî kuptimin symbolik të ktyne fjalve, vetem deshtem me thâné, se kto fjalë qi foli Empedokles duket se permle-dhin nji të vertetë me shum randsí. E njimend, po u vûm na me kujtue zhvillimin e brêznivet të nierzve, nuk ká me na rá gjithaq e vshtirë me hetue se gjith perparimi shoqnuer e kulturár kryhet mreñda nji luftës ndermjet dy rrymësh ndiesish në kundraveprim njana me tjetren e ndermjet dy fuqive nzitse qi perkognë me to.

Njana rrymë dán jo vetem nierzt marrë veçmas, por edhe popuj e shoqní, i anmikson, i shtyn në nji luftë të shkimumi njana me tjetren, mjesá tjetra i avitë, i rrethon me lidhnít e njaj ndiesije të perbashkët, tuj i nzitë edhe kah veprimi i perbashkët. Deri në shkallén mât t' ulten e shnjyerzimit mund të vêhen n' oroe shëjet e nevojës të nji avituni ndermjevedi. Nuk âsht aspak e vertetë theorija qi man se gjëja shpirtnore mât e ulta s' ka tjeter para sýsh veç luften e të gjithve kundra të gjithve. Nji gjëje kso dore, edhe po kje vñ n' oroe kund mât botë, kje shkaktue prej ndonji poshtnimi

